



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA ADMINISTRATIVE E APELIT

Nr. 31104-01903-86-2016 (12652) Rregj.Them.
Data Regjistrimi 28.04.2016

Nr. 1345 (86-2016-283) Vendimi
Datë 25.05.2016

V E N D I M
NË EMËR TË REPUBLIKËS

Gjykata Administrative e Apelit, e përbërë prej :

GJYQTAR - Kastriot SELITA

GJYQTAR - Altina NASUFI

GJYQTAR- Bernina KONDI

Asistuar nga sekretare gjyqësore Valbona Zenelaj në Tiranë, sot më datë 25.05.2016, shqyrtoi në dhomë këshillimi çështjen administrative me palë:

PADITËSE: Shoqëria "Netsyscom" shpk me seli në adresën: shëtitorja "Gjergj Fishat" pranë Hotel Lis, Lezhë.

E PADITUR: Drejtoria Rajonale Tatimore Lezhë.

Drejtoria e Apelimit Tatimor, pranë Drejtorisë së Përgjithshme Tiranë.

Me pjesëmarrjen e Avokaturës së Shtetit gjatë gjykimit në shkallë të parë.

OBJEKTI: Shfuqizimin e vendimit nr. 232 Prot. Datë 15.01.2015 të DRT-Lezhë dhe vendimin nr. 2059/2 Prot. Datë 23/02/2014 të Drejtorisë së Apelimit Tatimor Tiranë.

Shpenzimet gjyqësore në ngarkim të palës së paditur.

BAZA LIGJORE: Neni 15/a, 16, 17/a të Ligjit Nr. 49/2012 dt. 03.05.2012 "Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative", neni 28/a, neni 32 i ligjit "Për inspektimin në RSH" nr. 10433, datë 16.06.2011. Neni 14 i ligjit për kundërvajtjet Administrative. Neni 69 i Ligjit nr. 9920 datë 19.05.2008 "Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë".

Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Shkodër me vendimin nr. 27, datë 15.01.2016 ka vendosur :

1. "Rrëzimin e kërkesë padisë si të pabazuar në ligj e në prova.



2. *Shpenzimet gjyqësore në ngarkim të palës paditëse*

Kundër vendimit të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Shkodër, ka paraqitur ankim pala paditëse në datën 04.03.2016.

Pala paditëse në ankimin e paraqitur prej saj ka kundërshtuar vendimin e Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Shkodër duke parashtruar se:

1. Referuar ligjit nr. 10433/2011 "Për inspektimin në RSH dhe nenit 14 të ligjit "Për kundërvajtjet administrative" procesverbali i mbajtur nga inspektorët e palës së paditur nuk janë mbajtur konform ligjit, pasi nuk është mbajtur në vendin e konstatuar të shkeljes, fakt që provohet me faktin se nuk e ka firmosur askush nga pala paditëse.
2. Në rastin konkret konstatimi i shkeljes është bërë në datën 22.12.2015, ndërsa njoftimi i vlerësimit është bërë në datën 15.01.2015 dhe për pasojë nuk është respektuar afati 10 ditor i llogaritjes së vlerësimit nga pala e paditur referuar nenit 69 të ligjit nr. 9920/2008.

Sa sipër, pala e paditëse kërkon ndryshimin e vendimit të Gjykatës së Shkallës së Parë Shkodër dhe pranimin e padisë sipas objektit të saj.

Gjykata Administrative e Apelit, pasi e shqyrtoi çështjen në dhomë këshillimi, dëgjoi relacionin e përgatitur nga gjyqtari relator, si dhe analizoi shkaqet e ngritura në ankim, sipas përcaktimeve të ligjit nr.49/2012, në këndvështrim me kërkesat e ligjit material dhe procedural,

Pala paditëse i është drejtuar Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë në datën 26.03.2015 me kërkesë padi duke kërkuar:

Shfuqizimin e vendimit nr. 232 Prot. Datë 15.01.2015 të DRT-Lezhë dhe vendimin nr.2059/2 Prot. Datë 23/02/2014 të Drejtorisë së Apelit Tatimor Tiranë. Shpenzimet gjyqësore në ngarkim të palës së paditur.

Pala paditëse në lidhje me këto kërkitime i ka referuar si bazë ligjore në nenet 15/a, 16, 17/a të Ligjit Nr. 49/2012 dt. 03.05.2012 "Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative", neni 28/a, neni 32 i ligjit "Për inspektimin në RSH" nr. 10433 datë 16.06.2011. Neni 14 i ligjit për kundërvajtjet Administrative. Neni 69 i Ligjit nr. 9920 datë 19.05.2008 "Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë".

Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë me vendimin nr. 1699, datë 01.04.2015 ka vendosur shpalljen e moskompetencës tokësore për gjykimin çështjes dhe dërgimin e çështjes për gjykim Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Shkodër.

Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Shkodër, me vendimin nr. 27, datë 15.01.2016 ka vendosur: Rrëzimin e kërkesë padisë.

Kundër vendimit të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Shkodër ka bërë ankim pala paditëse brenda afatit ligjor.

Në këto rrethana gjykata e shqyrtoi çështjen administrative të paraqitur nëpërmjet këtij ankimi në dhomë këshillimi sipas përcaktimeve të nenit 49/1 të ligjit nr. 49/2012.

Rrethanat e çështjes

Nga aktet e dosjes gjyqësore të përcjella me ankimin kundër vendimit nr. 27, datë 15.01.2014, të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë rezulton se:

Drejtoria Rajonale Tatimore Lezhë me datë 22.12.2014 në zbatim të urdhrit të punës nr. 393 Prot. Date 22.12.2014 ka ushtruar kontroll në subjekti "Netsycom" sh.p.k ku është mbajtur akt-konstatimi me nr. 0456907, datë 22.12.2014. Ky akt është dërguar Drejtorisë

se Vlerësimit dhe Menaxhimit të të Ardhurave Tatimore pranë kësaj drejtorie, për dijëni dhe për veprime të mëtejshme nga ana e këtij sektori, nisur nga verifikimi i deklarimit të punonjësve të siguruar në periudhën 2014/11 sipas listëpageses subjekti ka deklaruar dhe paguar sigurime shoqërore dhe shëndetësore vetëm për administratorin Dede Bukaqeja. Nga verifikimi i deklarimeve të subjektit për shtesat dhe pakësimin e të punësuarve sipas E-SIG 027 rezulton se subjekti në datën 22.12.2014 ka bërë deklarimin e marrjes në punë të shtetasës Esmeralda Bukaqeja.

Ndaj subjektit ka dalë njoftim vlerësimi tatimore nr. 232 Prot. Datë 15.01.2015 të DRT-Lezhë, për detyrimin tatimore gjobë 500.000 lekë, mos deklarim punonjësish neni 119/2 i ligjit 9920/2008 i ndryshuar.

Drejtoria e Apelit Tatimor (DAT) me vendimin e tij nr. 2059/2 Prot. Datë 23.02.2014 ka vendosur lënien në fuqi të vendimit të mësipërm.

DAT (fq. 6-8 të fashikullit) në vendimin e tij ka argumentuar se gjoba e vendosur në masën 500.000 lekë është e drejtë, bazuar në nenin 119 pika 1 germa "a" pasi argumentet e paraqitura nga paditësi nuk përbëjnë argumente ligjorë dhe se nuk ka paraqitur asnjë provë mbi bazën e të cilit të provojë të kundërtën e vlerësimit tatimor të palës së paditur.

Në këto kushte pala paditëse i është drejtuar në datën 26.03.2015 Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë me kërkesë padinë me objekt, palë të paditura dhe bazë ligjore siç përshkruhet në pjesën hyrëse të këtij vendimi.

Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë me vendimin nr. 1699, datë 01.04.2015 ka vendosur shpalljen e moskompetencës tokësore për gjykimin çështjes dhe dërgimin e çështjes për gjykim Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Shkodër.

Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Shkodër me vendimin nr. 27, datë 15.01.2016 ka vendosur : Rrëzimin e kërkesë padisë.

Nga përmbajtja e vendimit nr. 27, datë 15.01.2016, të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Shkodër rezulton se:

1. Paditësi në parashtrimet e veta i referohet ligjit " Për Inspektimin në RSH" nr 10433 dt 16.06.2011, një ligji i gabuar, pasi ligji mbi bazën e të cilit operon administrata tatimore është ligji 9920/2008 "Për Procedurat Tatimore të R.Sh."dhe Udhëzimin nr.24 datë 02.09.2008/ për zbatimin e Ligjit nr. 9920 dt.19.05.2008 "Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar mbi bazën e të cilin operojnë dhe inspektorët e hetimit tatimore në terren në varësi të drejtorisë së kontrollit pranë drejtorive rajonale tatimore në rrethe.
2. Në rastin konkret konstatohet se vlerësimi i gjobës është bazuar në nenin 119 të Ligjit nr. 9920 datë 19.05.2008 "Për procedurat tatimore në RSH-së", i ndryshuar.
3. Udhëzimi nr.24 datë 02.09.2008 për zbatimin e këtij ligji, pika 119.1 "Mosdeklarimi i të punësuarve" shpreh : 119.1 *Organet tatimore duhet të kontrollojnë punëdhënësin për të verifikuar nëse deklarimet dhe pagesat e detyrimeve tatimore, si dhe të kontributeve të detyrueshme të sigurimeve shoqërore e shëndetësore janë të plota dhe të sakta.*
4. Të gjithë tatimpaguesit duhet të deklarojnë në organin tatimor përkatës të punësuarit (përfshirë dhe punonjësit e papaguar të familjes së personit fizik me të cilët ai punon e bashkëjeton ligjërish), që fillojnë punë për herë të parë të subjekti apo të punësuar rishtazi pranë tij me të dhënat e kërkuara për secilin prej tyre. Ky deklarim duhet të bëhet të paktën një ditë kalendrike përpara fillimit të punës së të punësuarve.

5. Referuar Udhëzimin nr. 24 datë 02.09.2008 pika 80.3 për zbatimin e Ligjit nr. 9920 dt. 19.05.2008 "Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar shprehet :

Kontrollet tatimore janë :

a) *Kontroll tatimor i plotë në vend.* Këto kontrolle janë gjithëpërfshirëse dhe ndërmerren për të kontrolluar të gjitha aspektet e biznesit të personit të tatueshëm për të gjitha periudhat kohore që nga kontrolli i plote i fundit dhe të gjithë llojet e tatimeve. Këto kontrolle kryhen bazuar në analizën e riskut.

b) *Vizitat fiskale.* Këto janë kontrolle të shkurtra të kryera gjatë një periudhe të shkurtër kohore për të verifikuar saktësinë e deklaratave dhe pagesave, si rregull vetëm për një periudhe të caktuar tatimore dhe vetëm për një lloj tatimi.....

c) *Verifikimet në vend.* Këto verifikime të shkurtra synojnë zbulimin në kohe të shkeljeve që kanë lidhje me regjistrimin e personave të tatueshëm (identifikimin e personave të paregjistruar), me përdorimin e pajisjeve fiskale, me përdorimin e pullave fiskale në mallrat e akcizës, me dokumentimin e mallrave në ruajtje, përdorim dhe transport, me dokumentimin e shitjeve dhe lëshimin faturave tatimore, etj..... *Këto verifikime kryhen pa njoftimin paraprak të personave të tatueshëm, por vetëm nëpërmjet prezantimit në momentin e verifikimit, të dokumentit personal të verifikuesit dhe urdhrin e ditës, të lëshuar nga drejtuesi i drejtorisë së kontrollit për verifikime në vend.*

Provohet se ndaj subjektit tatim pagues është ushtruar kontroll nga administrata tatimore i tipit *verifikim në vend*, (bie poshtë pretendimi i paditësit për njoftimin paraprak), i pajisur me urdhër pune nr 939 dt 22.12.2014, në vendndodhje të vete subjektit, ku është mbajtur dhe akt- konstatimi nr serie 0456907 dt 22.12.2014, në të cilën është bërë përkrahimi i gjendjes së faktit ku thuhet- *ne pune u gjet një punonjëse që nuk identifikohet.*

Në datën 12.01.2015 nga zyra e vlerësimit tatimore është mbajtur procesverbali i vlerësimit (brenda afatit ligjor që parashikon neni 96 i ligjit 9920/2008), ku nga verifikimi i deklaratimeve të vete subjektit sipas E-sig 027 rezulton se subjekti me dt 22.12.2014 ora 21:29:20 ka deklaruar dhe punonjësen tjetër Esmeralda Bukaqeja, me datë fillimi pune datën 20.12.2014, pasi sipas deklaratës së mëparshme i deklaruar si i punësuar ishte vetëm administratori Ded Bukaqeja, pra provohet se punësimi për punonjësen e gjetur në pune është bërë në të njëjtën datë të kontrollit, në orën 21:29:20 të po asaj date. Për pasojë konform nenit 68 të Ligjit nr.9920 dt.19.05.2008 "Vlerësimi tatimor" ku shprehet :

1. Vlerësimi tatimor

a) *është llogaritja e detyrimit tatimor të tatimpaguesit nga administrata tatimore.....*

5. *Administrata tatimore vlerëson detyrimin tatimor të tatimpaguesit, në përputhje me dispozitat e legjislacionit përkatës. Vlerësimi bazohet në :*

a) *informacionin, që përmban deklaratat tatimore e tatimpaguesit*

b) *rezultatet e një kontrolli, në përputhje me kreun X të këtij ligji*

c) *mënyrat alternative të vlerësimit, të parashikuara në nenin 72 të këtij ligji.*

Kur një vlerësim bëhet në përputhje me shkronjat "b" ose "c" të pikës 5 të këtij neni, barra e provës, që shuma e këtij vlerësimi është e pasaktë, bie mbi tatimpaguesin.

6. Detyrimet e vlerësuar sa më lart prej 500.000 leke janë hedhur në sistemin informatik tatimor dhe janë pasqyruar në njoftim vlerësimin Nr 232 DT 15.01.2015 objekt gjykimi duke u njoftuar subjekti, konform procedurave ligjore.

Kundër vendimit të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Shkodër kanë bërë ankim pala paditëse për shkaqet e paraqitura në pjesën hyrëse të këtij vendimi .

Vlerësimi i gjykatës

Në analizë të ankimit dhe shkaqeve të ngritura nëpërmjet tij, të akteve të dosjes, të vendimit objekt ankimi, si dhe në referim të përcaktimeve të ligjit material dhe procedural që gjen zbatim në rastin konkret, Gjykata Administrative e Apelit çmon se: Vendimi nr. 27, datë 15.01.2016, i Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Shkodër është rrjedhim i një procesi të zhvilluar në respektim të dispozitave të ligjit procedural dhe material dhe si i tillë duhet të lihet në fuqi.

Së pari: Pala paditëse në ankimin e paraqitur parashtron se, referuar ligjit nr. 10433/2011 "Për inspektimin në RSH dhe nenit 14 të ligjit "Për kundërvajtjet administrative" procesverbali i mbajtur nga inspektorët e palës së paditur nuk janë mbajtur konform ligjit, pasi nuk është mbajtur në vendin e konstatuar të shkeljes, fakt që provohet me faktin se nuk e ka firmosur askush nga pala paditëse.

Gjykata Administrative e Apelit çmon si të pabazuar në ligj e në prova këtë pretendim të palës së paditur dhe për rredhje e vlerëson të papranueshëm.

Rezulton e provuar se në momentin e kontrollit të ushtruar nga inspektorët e DRT Lezhë në datën 22.12.2014 ka rezultuar se në punë është gjendur një shtetase që nuk identifikohet. Ky akt konstatimi është firmosur rregullisht nga dy inspektorë të DRT Lezhë dhe për palën paditëse është bërë shënimi "refuzon firmën".

Rezulton se në këtë datë (22.12.2014) pranë organeve tatimore ka qenë i deklaruar si i punësuar vetëm administrator i shoqërisë paditëse Dede Bukaqeja. Në vijim në po këtë datë (22.12.2014) në orën 21:29:20 pala paditëse ka deklaruar si të punësuar rishtazi shtetasen Esmeralda Bukaqeja në pozicionin e punës "shitëse" nëpërmjet formularit "Pasqyra e të punësuarve për herë të parë, atyre rishtazi, si dhe të larguarve nga Puna" E-Sig 027 në datën 22.12.2014 (fq. 17 e fashikullit gjyqësor).

Gjykata çmon të pabazuar në fakt dhe në ligj pretendimin e palës paditëse se procesverbali i mbajtur nga inspektorët e palës së paditur nuk janë mbajtur konform ligjit, pasi nuk është mbajtur në vendin e konstatuar të shkeljes, fakt që provohet me faktin se nuk e ka firmosur askush nga pala paditëse.

Në rastin konkret akt-konstatimi i datës 22.12.2014 është mbajtur në ambjentet e palës paditëse në sheshin "Besëlidhja" Lezhë dhe firmosur rregullisht nga dy inspektorë të palës së paditur. Ky fakt provohet nga kuponi tatimor që i është bashkëngjitur akt konstatimit (fq. 16 e fashikullit gjyqësor).

Së dyti, Gjykata çmon se, me të drejtë gjykata e shkallës së parë ka vlerësuar se në rastin konkret konstatohet se vlerësimi i gjobës është bazuar në nenin 119 të Ligjit nr. 9920 datë 19.05.2008 "Për procedurat tatimore në RSH-së", i ndryshuar.

Neni 119 i ligjit nr. 9920/2008 përcakton se:

"Nëse nga verifikimi dhe kontrolli në vendndodhjen e biznesit rezulton se tatimpaguesi nuk ka deklaruar në organin tatimor çdo të punësuar rishtazi, të paktën një ditë kalendarike përpara fillimit të punës, përveç detyrimit për pagimin e shumës së

detyrimeve tatimore dhe kontributeve të sigurimeve shoqërore e shëndetësore, të llogaritura nga data e konstatimit, dënohet me gjobë si më poshtë:

- a) Tatimpaguesit e regjistruar si subjekte të tatimit mbi vlerën e shtuar dhe tatimit mbi fitimin, me gjobë prej 500.000 (pesëqind mijë) lekë;*
- b) Tatimpaguesit e tjerë, me gjobë prej 250.000 (dyqind e pesëdhjetë mijë) lekësh”.*

Në zbatim kësaj dispozite Udhëzimi nr. 24 datë 02.09.2008 për zbatimin e këtij ligji, pika 119.1 “Mosdeklarimi i të punësuarve” përcakton se : 119.1 *Organet tatimore duhet të kontrollojnë punëdhënësin për të verifikuar nëse deklaratimet dhe pagesat e detyrimeve tatimore, si dhe të kontributeve të detyrueshme të sigurimeve shoqërore e shëndetësore janë të plota dhe të sakta*

Në rastin konkret me të drejtë, Gjykata e Shkallës së Parë ka vlerësuar se vendimi i palës së paditur-DRT Lezhë për dënimin me gjobë të subjektit paditës është i bazuar në nenin 119 të ligjit nr. 9920/2008. Pasi referuar dispozitës së sipërcituar (gërma “a”) masa e gjobës e aplikueshme në rastin konkret është prej 500.000 (pesëqind mijë) lekë.

Rezulton se në momentin e kontrollit pala paditëse ka patur të padeklaruar një punonjëse, të cilën e ka deklaruar në orën 21:29:20 të po kësaj date. Në këto kushte me të drejtë pala e paditur ka vendosur marrjen e masës dënim me gjobë ndaj palës paditëse.

Së treti, Pala paditëse në ankimin e saj ka parashtruar se, në rastin konkret konstatimi i shkeljes është bërë në datën 22.12.2015, ndërsa njoftimi i vlerësimit është bërë në datën 15.01.2015 dhe për pasojë nuk është respektuar afati 10 ditor i llogaritjes së vlerësimit nga pala e paditur referuar nenit 69 të ligjit nr. 9920/2008.

Neni 69 pika 1 e ligjit nr. 9920/2008 përcakton se:

“Administrata tatimore, brenda 10 ditëve kalendrike nga data e llogaritjes së vlerësimit prej saj, i dërgon tatimpaguesit njoftimin e vlerësimit tatimor dhe kërkesën për pagesën e detyrimit tatimor:

- a) në rrugë elektronike, në përputhje me legjislacionin e komunikimeve elektronike dhe kur tatimpaguesit kanë dhënë pëlqimin për pranimin e njoftimit në rrugë elektronike, ose;*
- b) nëpërmjet shërbimit postar rekomandë.*

Marrja dijëni nga tatimpaguesi dhe llogaritja e të gjitha afateve që janë të lidhura me njoftimin e vlerësimit bëhen sipas parashikimeve të pikës 3, të nenit 23, të këtij ligji.”

Gjykata Administrative e Apelit çmon se mos respektimi i këtij afati nga pala e paditëur nuk passjell pavlefshëmiri të aktit administrative të kundërshtuar nga paditësi.

Neni 40 pika 4 e ligjit nr. 49/2012 përcakton se:

“Gjykata vendos rrëzimin e padisë dhe kur vlerëson se, pavarësisht shkeljeve procedurale të konstatuara të veprimtarisë administrative, pasojat do të ishin të njëjta”.

Në rastin konkret Gjykata çmon se, pala paditëse nuk arriti të provonte se nëse akti administrativ - njoftim vlerësimi nr. 232 Prot. Datë 15.01.2015 të DRT-Lezhë do të ishte njoftuar asaj brenda afatit 10 ditor, pasojat e këtij akti do të ishin të ndryshme. Pasojat e juridike të aktit administrativ - njoftim vlerësimi nr. 232 Prot. Datë 15.01.2015 të DRT-Lezhë ndaj subjektit tatimpagues fillojnë nga data e marrjes dijëni nga ky i fundit për këtë akt administrativ.

Referuar shkaqeve të ngritura në ankim nga pala paditëse, kjo Gjykatë çmon se ato, janë të pa mbështetura në ligj dhe nuk janë të tilla që mund të çenojnë vendimin e shkallës së parë. Pala paditëse nuk ka ngritur ndonjë shkak thelbësor që ka të bëjë me zgjidhjen në themel të çështjes dhe njëkohësisht shkaqet e ngritura nuk i referohen ndonjë shkeljeje procedurale që passjellin cënimin e vendimit të gjykatës së shkallës së parë.

Sa më sipër, pretendimet e parashtruara nga pala e paditëse në Gjykatën Administrative të Apelit për kundërshtimin e vendimit nr. 27, datë 15.01.2016 të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Shkodër janë të pabazuara në ligj dhe në prova dhe si të tilla të papranueshme.

Në rrethanat e përshkruara sa më sipër Gjykata Administrative e Apelit bazuar në nenin 50 gërma "b" të ligjit Nr. 49/2012, "Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave Administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative", çmon se vendimi nr. 27, datë 15.01.2016 i Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Shkodër duhet të lihet në fuqi.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Administrative e Apelit, bazuar në nenin 50 gërma "b" të ligjit nr. 49, datë 03.05.2012 "*Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatave Administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative*",

VENDOSI :

1. Lënien në fuqi të Vendimit nr. 27, datë 15.01.2016 të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Shkodër.
2. Shpenzime gjyqësore nuk ka.
3. Kundër këtij vendimi mund të bëhet rekurs në Kolegjin Administrativ të Gjykatës së Lartë brenda 30 ditëve nga e nesërmja e njoftimit të këtij vendimi.

U shpall në Tiranë sot më datë 25.05.2016.

GJYQTAR
Bernina KONDI
d.v

GJYQTAR
Altina NASUFI
d.v

GJYQTAR
Kastriot SELITA
d.v

Vertetohet njesia me origjinalin